



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 943/1 Prot.

Tiranë, më 19.09.2023

V E N D I M

Nr. 185, Datë 19.09.2023

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar², mori në shqyrtim ankesën nr. 157, datë 14.08.2023, të paraqitur nga z.Sh.D kundër Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor Tiranë dhe Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor, Dega Rajonale Berat në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “*bindjeve politike*”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e depozituar pranë Komisionerit, ankuesi Sh.D shpjegon se, ka qenë në marrëdhënie pune me Inspektoriatin Shëndetësor Shtetëror, Dega Rajonale Berat, në pozicionin shofer që prej vitit 2015. Ai shpjegon se, me shkresën nr.1416 prot., datë 29.08.2022, është njoftuar se i janë zgjidhur marrëdhëniet e punës në bazë të Urdhërit nr.119, datë 28.07.2022, të Kryeministrit “*Për miratimin e strukturës dhe organikës së Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor*”.

Ankuesi pretendon se, zgjidhja e marrëdhënieve të punës ka ardhur për shkak të bindjeve politike të cilat janë të kundërta me eprorët, si dhe për shkak të statusit të përndjekurit politik që ka si familje.

Fakti që zgjidhja e marrëdhënieve të punës është bërë pa shkaqe të arsyeshme, është kostatuar edhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat me Vendimin nr.141, datë 06.03.2023. Gjithashtu, pretendohet se punëdhënësi i ka ndërprerë marrëdhëniet e punës, duke e trajtuar në mënyrë të pabarabartë dhe diskriminuese gjatë procesit të zgjidhjes së marrëdhënieve të punës, në mënyrë të menjëhershme dhe të paligjshme. Gjatë kësaj procedure është trajtuar me neglizhencë duke u ndier i diskriminuar nga eprorët, për arsye se është i përndjekur politik dhe është trajtuar ndryshe nga kolegët e tjerë të ndodhur në të njëjtën situatë.

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

Përfundimisht, ankuesi kërkon nga Komisioneri, konstatimin e diskriminimit për shkak të bindjeve politike dhe marjen e masave për ndalimin e diskriminimit.

II. Procedura e ndjekur nga Komisioneri për shqyrtimin e ankesës.

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës së depozituar pranë Komisionerit, u konstatua se ajo kishte mangësi të anës formale, ndër të tjera, në lidhje me shkakun e pretenduar nga ana e ankuesit.

Për këtë arsye, nëpërmjet *email*-it të datës 17.08.2023, ankuesit i'u kërkuar të plotësojë ankesën me informacion shtesë, në lidhje me shkakun e pretenduar të bindjeve politike, plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm në lidhje me provueshmërinë e shkakut të pretenduar, si dhe vendosjen në dispozicion të Komisionerit të informacionit të nevojshëm për të bërë të mundur hetimin dhe verifikimin e pretendimit të ankuesit, se ai është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme, në raport me kolegë të tjerë, të ndodhur në kushte të njëjta me ankuesin.

Nëpërmjet *e-mailit* të datës 23.08.2023, ankuesi kërkoji kohë për plotësimin e ankesës, për shkak se e kishte të pamundur depozitimin e informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar brenda afatit të përcaktuar në njoftimin e mësipërm (*e-maili* datë 17.08.2023). Ankuesi nuk e plotësoi ankesën me informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar edhe pas kërkesës së paraqitur prej tij për shtyrjen e afatit. Nëpërmjet *e-mailit* të datës 06.09.2023, ankuesit i'u rikërkuar plotësimi i ankesës dhe depozitimi i informacionit dhe dokumentacionit. Pavarërisht kërkesave të ripërsëritura, ankuesi nuk depozitoi informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar.

Bazuar në aktet e vendosura në dispozicion nga ankuesi, rezulton se, ankuesi Sh.D ka qenë i punësuar me detyrë “Shofer”, pranë Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor, Dega Rajonale Berat. Me shkresën nr.1416 prot, datë 01.09.2022 “*Për zgjidhjen e marrëdhënies së punës në zbatim të urdhrin Nr.119, datë 28.07.2022*”, të Kryeinspektorit të Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor Tiranë, ankuesit i janë zgjidhur marrëdhëniet e punës. Rezulton se, motivacioni i deklaruar për zgjidhjen e marrëdhënies së punës me ankuesin, është ndryshimi i strukturës dhe organikës së institucionit, në zbatim të Urdhrit nr.119, datë 28.07.2022, të Kryeministrit “*Për miratimin e strukturës dhe organikës së Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor*”.

Ankuesi ka paraqitur pranë Komisionerit ankesën nr.157, datë 14.08.2023, duke pretenduar se është diskriminuar nga Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor Tiranë dhe Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor, Dega Rajonale Berat, për shkak të bindjeve politike.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës dhe bazuar në nenin 33, pika 4, germa “ç” të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: ç) nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim; ”, Komisioneri vlerëson se, ankesa nuk duhet të pranohet, pasi nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim, bazuar në arsyetimin vijues:

Ligji Nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me një listë të hapur shkaqesh duke parashikuar në mënyrë të shprehur shkakun e bindjeve politike, të pretenduar nga ankuesi. Konkretisht, në nenin 1, të LMD, parashikohet se : *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtetësinë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Bazuar në nenin 3, pika 1, të LMD, diskriminimi përcaktohet si : *“çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.”*

Referuar parashikimit të nenit 1, marrë së bashku me përkufizimin e diskriminimit, që ligji ka bërë në nenin 3, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit.

Në lidhje me shkakun e pretenduar të diskriminimit, pala ankuese duhet të provojë në *radhë të parë* se shkakun e pretenduar prej saj është një shkak që gëzon mbrojtje sipas ligjit dhe në *radhë të dytë* duhet të provojë ekzistencën e tij.

Në ankesën objekt shqyrtimi ankuesi Sh.D pretendon se, është diskriminuar për shkak të bindjeve politike. Komisioneri vlerëson se shkakun e bindjeve politike, është një shkak që gëzon mbrojtje sipas LMD.

Ankuesi ka identifikuar shkakun e bindjeve politike, si shkak të pretenduar diskriminues, duke shpjeguar në lidhje me shkakun se, marrëdhëniet e tij të punës janë zgjidhur për shkak të bindjeve të tij politike, të cilat janë të kundërta me ato të eprorëve të tij. Pavarësisht këtij pretendimi, ankuesi nuk vendosi në dispozicion të Komisionerit asnjë informacion se, cilat janë bindjet e tij politike dhe cilat janë bindjet e pretenduara politike që kanë eprorët e tij. Ankuesi nuk paraqiti asnjë dokumentacion për të provuar shkakun e pretenduar të diskriminimit atë të bindjeve politike.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se, pavarësisht se shkakun e bindjeve politike është një shkak që gëzon mbrojtje nga LMD, ankuesi nuk vendosi në dispozicion asnjë informacionin dhe

dokumentacion provues në mbështetje të pretendimit të tij në lidhje me shkakun e pretenduar të diskriminimit.

Referuar shpjegimeve që ankuesi ka paraqitur në formularin e ankesës, ai shprehet se, zgjidhja e marrëdhënieve të punës ka ardhur dhe për shkak të statusit të të përndjekurit politik, që kanë si familje. Në mbështetje të këtij pretendimi, ankuesi ka depozituar një vërtetim për dhënie statusi në emër të shtetasit Xh.D.D. Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, ankuesit i'u kërkua që të depozitonte dokumentin "Vërtetim për dhënie statusi", në formën e kërkuar nga ligji, pasi kopja e depozituar nuk ishte në një format të lexueshëm dhe në formën e kërkuar nga ligji.

Gjithashtu, ankuesi nuk vendosi në dispozicion të Komisionerit informacionin e nevojshëm në lidhje me kolegët me të cilët ankuesi krahasohet se është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme, që do t'i mundësonte Komisionerit për të vlerësuar dhe hetuar më tej, në lidhje me pretendimin e paraqitur nga ankuesi, se ishte trajtuar në mënyrë të pafavorshme në krahasim me kolegë të tjerë të cilët ndodheshin në të njëjtat kushte me të.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, bazuar në nenin 33, pika 4, gërma "ç", të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankesa e paraqitur nga ankuesi Sh.D kundër Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor Tiranë dhe Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor, Dega Rajonale Berat, nuk mund të pranohet, pasi nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32/1/a , nenin 33, pika 4, gërma "ç" të ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës Nr. 157 regj., datë 14.08.2023, të paraqitur nga ankuesi Sh.D kundër Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor, Tiranë dhe Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor, Dega Rajonale Berat, pasi nuk plotësohen kriteret e parashikuara nga ligji nr.10221, datë 04.02.2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkaku: Bindjet politike

Fusha: Punësim
Lloji i vendimit: Mospranim